



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme

URDHER

Nr/03 Date 16.4.2003

PER

**TRANSFORMIMIN E NDERMARRJES SHTETERORE "UJESJELLES FSHAT"
LUSHNJE. NE SHOQERI ANONIME " UJESJELLES FSHAT " SH. A LUSHNJE**

Drejtuar : Shoqerise ne formim e siper "Ujesjelles Fshat " Lushnje

Duke marre parasysh percaktimin e kapitalit themeltar te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi i Ndermarrjes "Ujesjelles Fshat" Lushnje nga ekspert kontabel te autorizuar sipas urdherit nr. 133 date 4.10.2002 te Ministrit te Ekonomise,

KONSTATOVA

Se ne baze te nenit 1 te Ligjit Nr. 8885, date 22.04 2002 "Per disa ndryshime ne ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Ligjin Nr.8067, date 15.02.1992; Nr.8099, date 28.03.1996; Nr. 8158, date 1.09.1997; Nr. 8482, date 10.05.1999, dhe me Dekretet Nr. 1195, date 14.08.1995 dhe Nr. 1615, date 20.09.1996 duhet te krijohen aktet e themelimit te shoqerise,

Persa me siper, ne mbeshtetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

URDHEROJ :

1. Transformimin e Ndermarrjes "Ujesjelles Fshat" Lushnje ne shoqeri te formes anonime "Ujesjelles Fshat" Sh..A Lushnje.
2. Anetar te keshillit te pare mbikqyres emerohen:
Z. Skender Hasa.
Z. Agim Akulli
Zj.Dhurata Xhaxhiu

3. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme dhe Drejtoria Juridike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri .

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

